



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

---

Numri i lëndës: 2022:134898

Datë: 01.02.2023

Numri i dokumentit: 03927674

**P. nr.101/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me Nd.nr.39/2022, të datës 16.12.2022, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.385/2022, të datës 23.06.2022, kundër të akuzuarit H. (A.) K. nga fshati D., Komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 358 par. 1. nën par. 1.3 të KPPK-së dhe nenit 2 par. 2, 8, 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), **më 01 shkurt 2023, nxjerri këtë:**

#### **A K T V E N D I M**

**I. MIRATOHET** marrëveshja me numër Nd.nr. 39/2022, të datës 16.12.2022 e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Malishevë, ndërmjet të akuzuarit H. (A.) K. nga fshati D., Komuna e M. dhe të dëmtuarës K. - Distrikti Gj. me përfaqësuesen ligjore A. M., në anën tjetër.

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.385/2022, të datës 23.06.2022.

**III. PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarit H. (A.) K. nga fshati D., Komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për shkak se i pandehuri dhe e dëmtuara së bashku me përfaqësuesen e saj ligjore, kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

**IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr.385/2022, të datës 23.06.2022, kundër H. (A.) K. nga fshati D., Komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata më 07.12.2022, e ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë e duke vepruar ne bazë të nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Institutin për Ndërmjetësim në Malishevë.

Më 16.12.2022, në Qendrën për Ndërmjetësim në M., është arritur marrëveshja Nd.nr 39/2022, në mes të palëve në procedurë. Andaj gjykata duke vepruar në bazë të dispozitës së nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovojë këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin më datën e pranimit nga gjykata përkatësisht nga data **01 shkurt 2023**, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u morën në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 358 par.1 nën par.1.3 të KPPK-së, e lidhur me nenin 2,15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL  
P.nr.101/2022, datë 01 shkurt 2023**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Njazi MORINA**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.